



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

Reagim i KMDLNj –së:

KEDS nuk e thotë të vërtetën, po manipulon me të vërtetën

Pas reagimit të KMDLNj –së për plaçkitjen që u bënë KEDS qytetarëve të Kosovës, së bashku me ndrikullën e këtij mashtrimi Zrre , duke ua faturuar rrymën e papaguar nga serbët e Kosovës atyre që nuk janë serbë dhe të cilët e vuajnë të zitë e ullirit për t'i paguar faturat, edhe ashtu shumë të larta, KEDS ka reaguar përmes shefit të tyre në Kosovë, në një tryezë të rrumbullakët me bizneset e Kosovës (të cilat i ka plaçkitur pamëshirshëm dhe ua ka dëmtuar biznesin deri në falimentim), duke mashtruar opinionin kinse kërkesa publike e KMDLNj –së të paguhet vetëm 70% e vlerës së faturës është kërkesë për të mos e paguar rrymën.

Gjatë dy viteve të fundit KMDLNj ka denoncuar keqbërësit e KEDS –it dhe Zrre –së kurse vendimi i Gjykatës së Apelit i ka dhënë plotësisht të drejtë KMDLNj –së për faktin se e detyron këtë binom plaçkitës ta ndërprejnë këtë mënyrë të faturimit të energjisë elektrike , i cili , përveç se është diskriminues në çdo aspekt, edhe materialisht i dëmton qytetarët joserbë të Kosovës për 22-30% të vlerës së përgjithshme të faturës .Për këtë arsye KMDLNj ka kërkuar që të paguhet 70% e vlerës së faturës ndërsa 30% e vlerës së mbetur duhet ta paguajnë serbët. Pra, nuk është e vërtetë se KMDLNj kërkon të mos paguhet rryma e shpenzuar por është e vërtetë se kërkon të mos paguhet rryma e pashpenzuar apo rryma që se kanë paguar të tjerët. KMDLNj, në të gjitha reagimet ka kërkuar që të paguhet rryma e shpenzuar por jo edhe rryma me fatura të fryra, ajo e manipulimeve me tarifa apo rryma që ka prodhuar fatura astronomike si pasojë e njehësorëve të manipuluar.

KMDLNj edhe tani kërkon që të paguhet rryma e shpenzuar e që nuk mund të jetë më e lartë se 70 – 75% e faturës. KEDS – i duhet të jep llogari për plaçkitjen që ua ka bërë dhe po ua bënë qytetarëve të Kosovës përmes faturimit racist, duhet të kompensojë dëmet e shkaktuara duke dëmtuar pajisjet e amvisërisë, duhet t'i zhvendosë bizneset, kalljen e shtëpive për shkak të defekteve të rrjetit por edhe humbjen e jetëve si pasojë e kalljes së shtëpive e të cilat nuk janë hetuar deri në fund.

Kush janë KEDS dhe Zrre e që nuk i zbatojnë vendimet e Gjykatës së Apelit, moszbatimi i të cilëve paraqet vepër penale?! Pse duhet ta pësojë qytetari i Kosovës shkaku se nuk qenka kompletuar Bordi i Zrre –së? Si mund KEDS –i të kërkojë që konsumatori i Kosovës t'ua mbulojë humbjet komerciale apo të arsyetohet se marrëveshja për faturimin diskriminues është marrëveshje e trashiguar dhe mbi atë bazë ende zbatohet përkundër vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit?

KMDLNj, gjatë takimit me kryeministrin Haradinaj e ka përcjellë shqetësimin e qytetarëve të Kosovës që pamëshirshëm plaçkiten nga KEDS, sigurisht me pëlqimin e Zrre duke kërkuar zgjidhje të shpejtë gjë që edhe ka premtuar kryeministri i Kosovës. KMDLNj do të takohet edhe me ministrin Valdrin Lluka të trajtojë këtë çështje dhe do të këmbëngulë që konsumatorët e dëmtuar, të kompensohen përmes një forme që do të ishte e pranueshme , në radhë të parë nga të dëmtuarit por edhe për ata që duhet ta bëjnë kompensimin. Në rast se kjo çështje do të zvarritet, atëherë do të thërrasë qytetarët për protesta deri sa të përfundojë ky diskriminim dhe plaçkitje e paskrupullt e qytetarëve të Kosovës.

KMDLNj është jashtëzakonisht i shqetësuar me sjelljen e papërgjegjëshme të deputetëve të Kuvendit të Kosovës që kanë mandat të përfaqësojnë dhe t'i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës e që në të njëjtën kohë janë votues të tyre.

23 nëntor 2017

Shërbimi për Informim